Prefekti i Tiranës z. Ruzhdi Keci duke i dorëzuar çmimin për shoqërinë civile znj. Valdet Sala



Milva Ikonimi duke i dorëzuar çmimin e qeverisjes z. Artur Kurti



Blendi Fevziu fitues i çmimit lidership për median



Pamje nga seancat e prezantimit te trajnimeve.

Lançimi i Trajnimeve Kalendar dhe i asistencës për Kompanitë nga NET

Pas një prezantimi në publik të kurrikulave të trajnimeve të zhvilluar në muajin Shkurt 2005, NET vijoi me ofrimin e trajnimeve të hapura të tipit kalendar gjatë vitit 2005. Këto trajnime u përqendruan në temat si: lidërsip për performancë, komunikim strategjik, menaxhim i projekteve, menaxhim financiar, komunikim etj. NET ofroi gjithashtu asistencë dhe konsulencë për kompani të ndryshme në sektorin privat të biznesit ose atë joqeveritar, të përshtatur sipas kërkesave dhe nevojave të vetë kompanive.



Ekspozitat publike dhe Forumi Qytetar në Elbasan dhe Fier

Gjithashtu në dhjetor 2005, Bashkitë e qyteteve Elbasan dhe Fier për herë të parë hapën dy ekspozita njëjavore që paraqitën para publikut punën e bërë me hartimin e strategjisë së zhvillimit dhe planit rregullues për secilin nga këta qytete, me mbështetjen e programit Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II). Ekspozicioni i planeve të qytetit pas një procesi intensiv konsultimi me aktorët dhe grupet e interesuara u realizua nëpërmjet një performance vizuale mjaft tërheqëse duke i ftuar qytetarët të njiheshin dhe të votonin mendimet e tyre lidhur me to. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i organizuar në këtë atmosferë nga bashkitë përkatëse, si në Elbasan edhe në Fier, ishte Forumi Qytetar, ku qytetarët dhe Bashkia diskutuan dhe votuan për vizionin dhe prioritetet e zhvillimit të ardhshëm të qytetit të tyre.



Nenkryetarja e Bashkise Fier Eriselda Cobo gjate fjales se rastit ne celjen ekspozites ne Fier



Kryetari i Bashkise Elbasan Ardjan Turku ne fjalën e hapjes se ekspozites



Qytetare ne Elbasan shprehin mendimet e tyre per zhvillimin e qytetit



Pamje nga zhvillimi i Forumit Qytetar ne Fier

Koncepti i ekspozites per Qytetin e se Ardhmes





Dritan Shutina ne workshopin e Co-PLAN ne konference



Pjesemarresit shqiptare duke shkëmbyer ide me homologet nderkombetare

Pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm në Gjenevë

Në tetor 2005, Co-PLAN dhe dy bashkitë Elbasan dhe Fier të përfshira në programin e asistencës Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II) morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm, organizuar në Gjenevë. Në këtë aktivitet të kombinuar ndërmjet ekspozitës dhe konferencës, krahas mjaft ekspozuesve nga vende të ndryshme, Co-PLAN dhe dy bashkitë paraqitën, nëpërmjet 3 paneleve, përvojën shqiptare dhe përpjekjet që kanë ndërmarrë lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë në përgjithësi. Co-PLAN mbajti gjithashtu një *workshop* mbi problematikën shqiptare të zhvillimit urban dhe qeverisjes dhe përvojën dhe modelin me pjesëmarrje të planifikimit dhe zhvillimit dhe të qeverisjes që ka arritur të ndërtojë në këto vite.



Pamje nga seanca plenare e konferences

(majtas) Kryetari i Bashkise Elbasan Ardjan Turku, Nën-kryetarja e Bashkise Tiranes Vali Bizhga, Hasan Drazhi, Bashkia Elbasan, Kryetari i Bashkise Fier Baftjar Zeqo; Lila Karaj Bashkia Elbasan



Gjate intervistes me gazetare (majtas) mbi përvojën dhe pjesëmarrjen e Co-PLAN



Kryetaret e Bashkise Kamez (aktuale dhe te meparshem), perfaqesues te bashkise dhe komunitetit takohen se bashku ne inagurimin e rruges

Rruga Co-PLAN ne Bathore

Nje rruge me shume ne Bathore e cila mban emrin e Co-PLAN. Në mirënjohje të punës gati 10-vjeçare dhe kontributit që Co-PLAN ka dhënë në zhvillimin e komunitetit të zonës së Bathores si dhe të Bashkisë Kamëz në tërësi, përsa i përket rritjes së ndërgjegjësimit, rritjes së kapaciteteve dhe nderhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës bazë, komuniteti i zonës i propozoi Këshillit Bashkiak Kamëz që një prej rrugëve kryesore në zonën e Bathores të emërtohej Co-PLAN.

Ky vlerësim simbolik për punën tonë nga Bashkia Kamëz shpreh më së miri vijueshmërinë e filozofisë së bashkëpunimit institucional të Co-PLAN, përtej përkatësive dhe dallimeve politike dhe partiake të forcave të ndryshme, të cilat kanë drejtuar në periudha të ndryshme Bashkinë Kamëz, dhe me gjere, në të gjitha komunitetet ku Co-PLAN ka qenë aktiv me punën e tij.

Në aktivitetin festiv te rastit të mbajtur në dhjetor per inagurimin e kesaj rruge morën pjesë kryetarët e Bashkisë Kamëz në vite, autoritetet vendore, komuniteti i zonës, si dhe organizata të tjera. Kjo shënoi gjithashtu përfundimin e njërit prej projekteve të Co-PLAN në këtë zonë, atë të "Forcimit të Kapaciteteve të Komuniteteve në Nevojë".





Stafi i Co-PLAN në 2005

Nga e majta: (lart) Sotir Dhamo, Florjan Nuri, Vezir Muharremaj, Anila Gjika, Etleva Goxhaj, Dritan Shutina, Enton Derraj, Gavrosh Zela, Darina Kokona, Redona Raca, Ilir Duka, Rudina Toto, Jorik Haskaj, Raimond Pengu, Indrit Faja; (poshtë) Jonida Sinani, Floreta Pirushi, Oreola Caliqi, Orjana Arapi, Manjola Kapedani, Florjan Ravoniku

(nuk përfshihen në këtë fotografi Flamur Kuçi, Amalia Tola dhe Jorida Cila)



Social activities of staff



Profili i Organizatës

Misioni dhe Vlerat

Co-PLAN është një organizatë shqiptare zhvillimi me një përvojë të afirmuar në fushën e zhvillimit, planifikimit dhe qeverisjes urbane. Gjatë këtyre viteve, Co-PLAN ka nxitur dhe zhvilluar modele konkrete për zhvillimin e komuniteteve dhe qyteteve, përballe sfidave të reja të urbanizimit, demokratizimit dhe decentralizimit në vend, duke vendosur në qendër partneritetin, përfshirjen dhe pjesëmarrjen; ndërkohë, nga ana tjetër duke punuar për të sjellë njohuritë ndërkombëtare më të fundit në këtë fushë. Co-PLAN ka qenë në gjendje të dëshmojë se, në realitetin shpeshherë të vështirë të komuniteteve në zonat urbane në Shqipëri, ndryshimet pozitive sociale dhe urbane janë të mundshme.

DEKLARATA E MISIONIT:

Co-PLAN është një organizatë jofitimprurëse që kontribuon në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe rajonal, duke mundësuar një qeverisje të mirë, zhvillimin e shoqërisë civile dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së komunitetit.

Filozofia e punës së Co-PLAN bazohet në vlerësimin që ndajnë pjesëtarët e organizatës për partneritetin, ndryshimin, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Co-PLAN nxit zhvillimin vetjak dhe profesional të stafit. Tre janë kompetencat që përshkruajnë më së miri stafin e Co-PLAN:

- **Bashkëpunues.** Bashkëpunimi është një nga vlerat më të spikatura të Co-PLAN, i cili përfshin vlerësimin e organizatës për partneritetin dhe një pjesëmarrje të hapur në çdo nismë të ndërmarrë.
- **I Përgjegjshëm.** Pjesëtarët e Co-PLAN ndihen të përgjegjshëm për veprimet e tyre. Kjo kompetencë flet gjithashtu për vullnetin e Co-PLAN për të qenë transparent (si për shembull monitorimi nga KPMG).
- **Krijues.** Stafi i Co-PLAN është vazhdimisht i përkushtuar për të qenë një hap para të tjerëve, si në aspektin profesional dhe në atë personal, gjë që demonstron në përpjekjet për të sjellë modele dhe praktika të reja zbatimi në fushën që vepron.

Co-PLAN do të vazhdojë përpjekjet për të qenë një organizatë e qëndrueshme, pavarësisht ndryshimeve të jashtme dhe të brendshme, duke luajtur një rol konkret në nxitjen dhe diskutimin në një mënyrë të vlefshme të problematikës së zhvillimit në Shqipëri dhe ofrimin e alternativave dhe modeleve për zgjidhjen e tyre, në përputhje me misionin dhe objektivat e përcaktuara dhe qëllimet më të përgjithshme të shoqërisë shqiptare.



Zhvillimi i një séance planikimi të përvitshme të projekteve

Orientimi nga aktivitete në tema

Planifikimi është një komponent mjaft i rëndësishëm në Co-PLAN. Planifikimi organizativ dhe strategjik i përgjithshëm 6-mujor dhe ai vjetor janë tashmë instrumenta të përhershëm për të rishikuar dhe planifikuar aktivitetet e projekteve si dhe për të siguruar sinergji, shkëmbim të ndërsjellë dhe vijueshmëri ndërmjet projekteve. Çdo vit organizata kryen një periudhë refleksioni e cila realizohet në Takimin e Refleksionit, Vlerësimit dhe Planifikimit të brendshëm. Ky është një moment kur stafi reflekton mbi arritjet dhe diskuton mbi të ardhmen.






Stafi gjate nje takimi reflektimi ne Voskopoje

Veprimtaria e Co-PLAN është ristrukturuar së fundi dhe do të përqendrohet në vazhdim në katër fusha tematike: menaxhimi urban dhe rajonal, menaxhimi mjedisor i bashkive, strehimi dhe zhvillimi institucional dhe organizativ. Ndërkohë, "forcimi i shoqërisë civile" dhe zhvillimet në rrafshin më të gjerë, si për shembull integrimi Evropian i Shqipërisë, janë dy tema të ndërthurura me zbatimin e aktiviteteve në secilën prej katër fushave të mësipërme.


Skema e riorganizimit të punës së Co-PLAN sipas fushave tematike



Struktura e re organizative

Co-PLAN ka një strukturë organizative të konsoliduar me një ndarje të qartë të funksioneve. Bordi Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv kanë përgjegjësi dhe role të përcaktuara si duhet. Strukturat vertikale sigurojnë cilësinë dhe menaxhimin e duhur të punës. Procedurat administrative dhe menaxheriale për veprimtari-në e përgjithshme organizative janë hartuar dhe përcaktuar në Manualin e Politikave dhe Procedurave, i cili siguron udhëzime dhe rregulla të aplikueshme nga i gjithë stafi, menaxherët e projekteve dhe pro-grameve. Gjithashtu, Co-PLAN ka hartuar Deklaratën e Vlerave dhe Kodit të Etikës të organizatës.

Në vazhdim, Co-PLAN do të vazhdojë të funksionojë sipas skemës së paraqitur më poshtë, në përputhje me ndarjen tematike të punës.



BORDI DREJTUES I CO-PLAN

Z. Sokol Çelo u diplomua për matematikë speciale në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës dhe është specializuar në fushën e Administrim-Biznesit. Gjatë karrierës së tij ka punuar si pedagog pranë Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Bujqësor, koordinator projektsh me GTZ (Kooperimi Teknik Gjerman), konsulent i jashtëm për organizata zhvillimi të huaja dhe vendase që operojnë në Shqipëri etj. Nga Maji i vitit 2005 është Menaxher kombëtar i Projektit të PNUD në mbështetje të INSTAT. Përvoja e tij kryesore është në çështjet e zhvillimit organizativ dhe institucional dhe si ekspert i çertifikuar për moderim, trajnim dhe vlerësim projektsh. Nga viti 1999 është këshilltar i jashtëm i Co-PLAN dhe nga viti 2002 Drejtor i Bordit Drejtues.



Sokol Çelo

Drejtor i
Bordit Drejtues



Valdet Sala

Anëtare Bordi

Znj. Valdet Sala ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë civile. Ajo është diplomuar për fizikë speciale në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Në karrierën e saj profesionale ka punuar në poste drejtuese të rëndësishme, ku mund të përmendim: ish-sekretare në Komitetin Qendror të Rinisë, Drejtore e Bibliotekës Kombëtare Tiranë, Drejtore Programi në Fondacionin SOROS (Shoqëria e Hapur) për Shqipërinë dhe së fundi këshilltare për çështjet e shoqërisë civile dhe përkatësisë gjinore për Ballkanin Perëndimor, pranë European Foundation. Ajo është themeluese e Shoqatës "Refleksione" dhe ka shkruar mjaft artikuj në lidhje me dhunën, trafikun dhe çështje të tjera të gruas shqiptare, duke përfaqësuar lëvizjen e gruas në shumë konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Që nga viti 1999 është anëtare e Bordit Këshillimor të Co-PLAN dhe nga viti 2002 anëtare e Bordit Drejtues.

Z. Sef Sloodweg ka lindur në Holandë dhe ka studjuar për gjeografi sociale dhe planifikim urban/rural në Universitetin e Nijmegenit, ku vazhdoi si studiues shkencor pranë 'Institutit Ekonomik' të këtij universiteti. Gjatë 1985-1991 punoi si këshilltar për politikën e strehimit dhe ekonominë vendore pranë 'Workgroup 2000' dhe gjatë 1991-1995 pranë studios 'RIGO Research & Advice BV' në Amsterdam. Ai ka punuar për klientë si ministri, bashki, shoqatat e strehimit dhe organizatat e banorëve. Fushat e tij të interesit janë politikën novatore ekonomike vendore, rinovimi urban; strehimi social, pjesëmarrja qytetare, integrimi i emigrantëve, kujdesi për moshat e treta dhe procesi i tranzicionit në Evropën Lindore. Ai është themelues i Fondacionit "Crossover" më 1990, ku punoi deri më 1995 për shkëmbimin e përvojave në politikën e strehimit ndërmjet Evropës Lindore dhe asaj Perëndimore. Gjatë 1995-2001 ka punuar në Shqipëri dhe është bashkëthemelues i Co-PLAN si një agjensi konsulence dhe shërbimesh në fushën e politikave dhe praktikave urbane. Që prej vitit 1999 punon me SNV, fillimisht si Koordinator i zyrës në Fier dhe së fundmi si këshilltar në Cotonou, Bénin.



Sef Sloodweg

Anëtar Bordi

Financat dhe transparencja

Co-PLAN është forcuar si organizatë duke patur transparencën si boshtin e suksesit të arritur. Co-PLAN i kushton vëmendje dhe përpjekje të vazhdueshme mbatjes dhe ruajtjes së transparencës së arritur, falë dhe sistemit të shëndoshë financiar me të cilin operon. Financat dhe procedurat e Co-PLAN kontrollohen dhe verifikohen rregullisht çdo vit nga organizata e njohur Ndërkombëtare KPMG. Këto raporte financiare, Co-PLAN ua shpërndan rregullisht të gjithë institucioneve financuese dhe partnerëve kryesorë të saj. Çdo vit Co-PLAN organizon Ditën e Hapur për publikun për të ndarë dhe komunikuar punën dhe arritjet e organizatës me partnerët, donatorët si dhe median. Gjithashtu, botimi i Raportit Vjetor të Organizatës është një tjetër përpjekje e rëndësishme e Co-PLAN për një funksionim sa më të hapur dhe transparent.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit në www.co-plan.org

Deklarata e Auditimit nga KPMG për Co-PLAN

Raport i auditorëve të pavarur për
Drejtorin Ekzekutiv të Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Tiranë më 31 Mars 2006


Ne kemi audituar bilancin kontabël të Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit (Organizata) deri më 31 Dhjetor 2005, bashkëngjitur këtij raport, si dhe pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve dhe të fluksit të parave, që lidhen me këtë bilanc, për vitin ushtrimor që mbyllet. Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën përgjegjësinë e drejtimit të organizatës. Përgjegjësia jonë është të japim mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Sipas këtyre standardeve ne jemi të detyruar të planifikojmë dhe ushtrojmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme mbi faktin nëse këto pasqyra financiare nuk përmbajnë gabime ose shmangie materiale. Një auditim përfshin shqyrtim të evidencës që mbështet shumatat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare, mbi bazë testimi. Një auditim përfshin gjithashtu edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe gjykimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi. Ne besojmë që auditimi ynë siguron baza të shëndosha për gjykimin tonë.

Sipas gjykitimit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në tërësinë e materialit, të gjendjes financiare të Organizatës deri më 31 Dhjetor 2005 si dhe të rezultatit të veprimeve të saj e të fluksit të parave për vitin që mbyllet, në përputhje me metodën "kontabilizim fondesh" siç përshkruhet në Shënimin 2.

Ky raport lëshohet për informacion dhe përdorim vetëm për drejtimin e Organizatës dhe donatorët e saj. Rrjedhimisht, materiali nuk duhet përdorur për qëllime të tjera dhe për këtë arsye nuk duhet shpërndarë pa marrë pëlqimin tonë me shkrim.

KPMG Albania sh.p.k



Pasqyrat Financiare për Co-PLAN 2005

Pasqyra e Bilancit në datën 31 Dhjetor 2005 për Co-PLAN (në EUR)

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Asetet		
Arka dhe Banka	704,300	272,217
Debitorë projekti	714,867	1,444,057
Debitorë të tjerë	144,478	780
Asete fikse, neto	69,429	80,859
Totali i aseteve	1,633,074	1,797,913
Detyrimet, Fondet e Projekteve dhe Fonde të Tjera		
Detyrimet	14,990	10,067
Fondet e projekteve	1,400,578	1,619,147
Fonde të tjera	217,506	168,699
Totali i detyrimeve	1,633,074	1,797,913

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2005 për Co-PLAN (në EUR)

	2005	2004
Të ardhurat		
Financuar nga donatorët	475,002	723,603
	475,002	723,603
Shpenzimet		
Shpenzime programi	(445,515)	(676,119)
Shpenzime administrative	(28,799)	(40,896)
Fonde nga donatorët alokuar te fondi rezervë	(5,818)	(9,962)
	(480,132)	(726,977)
Defiçiti i të ardhurave dhe shpenzimeve para të ardhurave të tjera	(5,130)	(3,374)
Të ardhura të tjera		
Të ardhura nga interesat	3,300	2,576
Shitja e aseteve fikse	15,056	-
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit, neto	24,083	(10,890)
Të ardhura nga aktivitete të tjera	13,340	11,688
	55,779	3,374
Sufiçiti i të ardhurave mbi shpenzimet para alokimit të fondit rezervë	50,649	-
Alokuar te fondi rezervë	(50,649)	-
Rezultati i vitit	-	-

Pasqyrat Financiare për NET 2005

Pasqyra e Bilancit në datën 31 Dhjetor 2005 për NET- Rrjeti për Shkëmbime dhe Trajtime (në EUR)

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Asetet		
Arka dhe Banka	234,595	132,608
Debitorë projekti	87,200	201,750
Debitorë të tjerë	538	-
Asete fikse, neto	127,459	144,023
Total assets/ Totali i aseteve	449,792	478,381
Detyrimet, Fondet e Projekteve dhe Fonde të Tjera		
Detyrimet	98,397	4,097
Fondet e projekteve	194,790	317,679
Fonde të tjera	156,605	156,605
Totali i detyrimeve	449,792	478,381

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2004 për NET- Rrjeti për Shkëmbime dhe Trajtime (në EUR)

	2005	2004
Të ardhurat		
Financuar nga donatorët	155,908	86,856
	155,908	86,856
Shpenzimet		
Shpenzime programi	(151,438)	(65,497)
Shpenzime administrative	(23,640)	(23,040)
	(175,078)	(88,537)
Defiçiti i të ardhurave dhe shpenzimeve para të ardhurave të tjera	(19,170)	(1,681)
Të ardhura të tjera		
Të ardhura nga interesat	1,640	653
Të ardhura nga aktivitete të tjera	17,230	947
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit, neto	300	81
	19,170	1,681
Rezultati i vitit	-	-

Shënim: NET – Rrjeti për Shkëmbime dhe Trajtime është një program i Co-PLAN i cili shihet si një produkt i Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Kontabiliteti dhe auditimi i NET janë të ndarë nga Co-PLAN, bazuar në sistemin e regjistrimit të dyfishtë.

Projektet në zbatim dhe të reja

FUSHA TEMATIKE	Nr.	EMRI I PROJEKTIT	AGJENSIA DONATORE	BUXHETI (EUR)	PERIUDHA E PROJEKTIT
Menaxhimi Urban dhe Rajonal	1.	Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II)	Qeveria Holandeze	1,152,552	2003 - 2006
	2.	Buxhetimi me Pjesëmarrje në Bashkinë Elbasan	Banka Botërore	40,250	2005 - 2006
	3.	Lehtësimi i Partneriteteve	Cordaid	212,400	2005 - 2007
	4.	Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integritetit të Komunitetit të Zonës Informale në Kënetë, Durrës	Qeveria Austriake	351,748	2004 - 2007
	5.	Forcimi i Kapaciteteve të Komuniteteve në Nevojë në Shqipëri	Novib	150,000	2003 - 2005
	6.	Bashkëveprimi Ndërkomunal në Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimin Rajonal	SOROS/NOSA	75,000	2006 - 2008
Menaxhimi Mjedisor	7.	Zhvillimi Urban dhe Përmirësimi Mjedisor në Bashkinë Kamëz nëpërmjet Bashkëpunimit Publik-Privat dhe Pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile	Bashkimi Evropian (nënkontraktuar nga CISP)	262,920	2003 - 2006
	8.	Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë	Cordaid	199,577	2006 - 2007
Zhvillimi Organizativ Institucional	9.	NET Rrjeti për Shkëmbim dhe Trajnim	Cordaid	550,000	2004 - 2007

Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II)

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II)	2003-2006	Ambasada e Vendeve të Ulëta në Tiranë	432/10021	PO305-00

Programi “Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane” (EGUG II) zbatohet në dy bashkitë Elbasan dhe Fier. Programi financohet nga Qeveria Holandeze nëpërmjet Ambasadës së Vendeve të Ulëta Tiranë me një buxhet 1,152,552 Euro. Qëllimi i programit është ndërtimi i modeleve shqiptare të qeverisjes së mirë urbane. Co-PLAN, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme (ish MPVD) dhe Shoqatën e Bashkive Shqiptare (SHBSH), po mbështet këto dy bashki për të realizuar komponentët e mëposhtëm të programit, bazuar në një frymë pjesëmarrjeje të orientuar nga kërkesa:



Seance prezantimi e Detyres së Projektimit për Planin Rregullues Elbasan



Qytetarët diskutojnë për zhvillimin hapësor të qytetit në ekspozitën e Elbasanit

1. Hartimi i Strategjive të Zhvillimit për Qytetet e Elbasanit dhe Fierit. Krijimi i strategjive të qytetit, të parashtruara si një domosdoshmëri nga bashkitë e këtyre dy qyteteve, është fokusi kryesor i asistencës së programit EGUG II. Hartimi i këtyre strategjive ka ndjekur një proces intensiv me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe aktorëve të interesit, i cili kulmoi në vitin 2005 me organizimin e Forumit Qytetar në Elbasan dhe Fier. Në këto forume, qytetarët diskutuan dhe votuan për vizionin dhe prioritetet e zhvillimit të parashtruara në Strategji, të cilat mbulojnë katër fushat tematike të zhvillimit urban, zhvillimit ekonomik, mjedisit, dhe arsimit dhe kulturës.

Në të dy qytetet Elbasan dhe Fier u hapën gjithashtu

dy ekspozita me qëllimin e informimit të publikut mbi rezultatet e strategjisë së zhvillimit të qytetit dhe planit rregullues. Qytetarët ndoqën me interesim këto ekspozita të cilat sollën një risi në qytet me anë të materialeve të tyre të larmishme grafike dhe mbi të gjitha ata kishin mundësi që të jepnin mendimin e tyre mbi zhvillimin e qytetit. Gjithashtu në proces hartimi janë edhe Planet Rregulluese për qytetet Elbasan dhe Fier, në kuadër të asistencës së programit. Në vitin 2005, të dy bashkitë përfunduan dhe paraqitën Detyrën e Projektimit të këtij plani, dhe kaluan me sukses miratimin teknik dhe ligjor në të gjitha instancat vendore dhe qendrore.




Perfaqesues të Bashkise Fier dhe Co-PLAN në promovimin e javes së qytetit në ekspozitën e Fierit



Seanca prezantimi te Detyres se Projektimit te Planit Rregullues; (djathtas) ne takimin e Keshillit Bashkiak Elbasan; (lart) per qytetin e Fierit, ne takimin KRRTRSH



2. Zbatimi i projekteve konkrete. Projektet konkrete janë një komponent kryesor i programit EGUG II. Sipas planifikimit, gjatë vitit 2005, të dy bashkitë Elbasan dhe Fier identifikuan projektet përkatëse, në përputhje me nevojat e tyre dhe në favor të zbatimit të strategjive të zhvillimit të sapohartuara. Ndërhyrjet në Elbasan dhe në Fier janë përqendruar në përmirësimin dhe shtimin e hapësirave të gjelbra. Paralelisht, ka vazhduar zbatimi i projekteve të nisura më parë, si krijimi i sistemit të informacionit në Bashki.



Pamje nga ndërhyrjet e projekteve për krijimin e lulishteve neper lagjet te qytetit

3. Zhvillimi i Platformës së Përhapjes së Njohurive. Dokumentimi dhe përhapja e përvojës dhe njohurive të zbatimit të programit EGUG II përbën komponentin e tretë të rëndësishëm. Disa nga produktet e rëndësishme që po përgatiten për këtë qëllim janë një CD *Toolkit*, një dokumentar etj. Në 2005 dy bashkitë Elbasan dhe Fier morën pjesë në Konferencën për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Gjenevë ku, nëpërmjet stendave, paraqitën përvojën e tyre të planifikimit dhe zhvillimit. Dy bashkitë shkëmbyen gjithashtu përvojën me homologë nga disa bashki në Republikën Çeke nëpërmjet një vizite të organizuar nga programi.

Buxhetimi me Pjesëmarrje në Elbasan

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Buxhetimi me Pjesëmarrje në Elbasan	2005-2006	Banka Botërore	7134464	P0502-00

Për herë të parë në vitin 2005, në Bashkinë Elbasan u zbatua procesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje (BP). Ky projekt u financua nga Banka Botërore me një vlerë 40,250 Euro. Zbatimi i projektit u menaxhua nga Co-PLAN, ndërsa Bashkia Elbasan koordinoi procesin në terren, me lehtësimin e dy organizatave lokale: Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CSDC) dhe Agjensia Rajonale për Zhvillimin (RDA), të cilat u identi-



Banoret duke perzgjedhur nevojat prioritare per nderhyrje ne lagjen e tyre

fikuan pas një periudhë takimesh konsultative intensive me aktorët e interesuar.

Projekti i Buxhetimit me Pjesëmarrje në Elbasan kishte për qëllim iniciimin e një praktike të re për sa i përket përfshirjes së drejtpërdrejtë të komunitetit përgjatë ciklit të hartimit të buxhetit të investimeve të Bashkisë. Kjo përfshirje siguron një shpërndarje më të mirë dhe efikase të buxhetit të investimeve të Bashkisë në përputhje me nevojat më parësore të komunitetit. Harmonizimi i Buxhetimit me Pjesëmarrje me Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit të hartuar në kuadër të Programit Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II), shërbeu

më së miri për të bërë lidhjen konkrete ndërmjet qëllimeve dhe objektivave strategjike afatgjatë të zhvillimit të qytetit me prioritetet afatshkurtra të komunitetit.

Buxhetimi me pjesëmarrje në Elbasan u zhvillua në 3 faza kryesore. Fillimisht u zhvilluan dy raunde takimesh me komunitetin, nëpërmjet të cilave u bë informimi dhe ku banorët përzgjedhën prioritetet e tyre për investimet si dhe përfaqësuesit e tyre (20 gjithsej). Këto prioritetet, në fazën e dytë, iu nënshtruan një shqyrtimi nga Komisioni i Buxhetimit të ngritur, mbi bazën e një metodologjie me kritere vlerësimi. Sipas planit, Komisioni zhvilloi disa takime dhe ndërmori një varg vizitash në terren për të vëzhguar nga afër dhe vlerësuar rëndësinë e ndërhyrjes prioritare për përfituesit, lagjen, zonën dhe qytetin; në përfundim të të cilave vendosi për listën prej 20 ndërhyrjesh prioritare për miratim nga Këshilli Bashkiak. Suksesi kryesor i projektit u shënuar në fazën e tretë, kur Këshilli Bashkiak miratoi njëzëri 20 prioritetet e propozuara nga Komisioni i Buxhetimit, bashkë me buxhetin përkatës për zbatimin e tyre, nga buxheti i përgjithshëm i investimeve të Bashkisë për vitin 2006.

Përvoja e parë e buxhetimit me pjesëmarrje në Elbasan rezultoi mjaft e suksesshme. Disa nga arritjet kryesore janë:

- **Njohja, miratimi, formalizimi i procesit të BP-së nga Këshilli Bashkiak.** Buxhetimi me pjesëmarrje është miratuar tashmë si një proces dhe mekanizëm institucional në ligjin organik të Bashkisë, krahas një fondi për kryerjen e aktiviteteve të buxhetimit me pjesëmarrje. Pra, në vazhdim, buxheti vjetor i Bashkisë Elbasan do të hartohet nëpërmjet këtij procesi me pjesëmarrje. Qytetarët elbasanas do të kenë një zë më të fuqishëm dhe konkret në marrjen e vendimeve për investimet prioritare të Bashkisë, duke çuar në një rritje të përgjegjshmërisë të qeverisë vendore.
- **Përfshirja dhe pjesëmarrja.** Në këtë proces u përfshinë drejtpërdrejt disa drejtori kyçe të Bashkisë: drejtoria e politikave të zhvillimit ekonomik, në rolin e koordinatorit të procesit; taksat; financa dhe buxheti; si dhe pronat publike dhe prokurimi.



Grupi i punës gjatë një vizite në terren për vlerësimin e prioritetëve në fazën e "karvanit"

Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Buxhetimit, me një përfaqësim të drejtë dhe të zgjeruar, me mandate të përcaktuara të anëtarëve, me statutin e organizimit të procesit dhe rregulloren e funksionimit, ishte një hallkë kyçe për realizimin e procesit. Komisioni përbëhej nga 20 përfaqësuesit e zgjedhur nga komuniteti (vetëm gjysma e tyre me të drejtë vote), katër përfaqësues nga grupet tematike të Strategjisë së Zhvillimit duke siguruar kështu një mbulim ndërsektorial; si dhe 10 zyrtarë të administratës së Bashkisë.

Hartimi i buxhetit në bashkëpunim me komunitetin gjeti një mbështetje të gjerë

nga banorët. Pjesëmarrja e tyre është një nga faktorët kryesorë. Një vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së të gjithë komunitetit, si gjeografikisht edhe për sa u përket kategorive të ndryshme siç janë: gratë, të cilat në shifra të përgjithshme përbënin 30-40% të numrit të pjesëmarrësve nëpër takime; grupet etnike si romët dhe ballkano-egjiptianët; familjet në vështirësi ekonomike të trajtuara me ndihmë nga shteti; si dhe të rinjtë të përfaqësuar nëpërmjet studentëve të Universitetit të Elbasanit.

Përfshirja e aktorëve lokalë (2 organizatave) në lehtësimin e procesit, duke përfshirë mbështetjen e Universitetit në komunikimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, ka hedhur bazat për një qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në vitet në vazhdim.



Faza e informimit e realizuar me përfshirjen e studentëve

Programi për Lehtësimin e Partneriteteve

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Lehtësimi i Partneriteteve	2005-2006	Cordaid	432/10016A	P0501

Programi Lehtësimi i Partneriteteve financohet nga organizata ndërkombëtare holandeze e zhvillimit Cordaid. Ne vazhden e dy projekteve të mëparshme të ngjashme, përkatësisht, “Drejt një Shoqërie Civile më të Fortë” dhe “Kalimi në një Shoqëri Civile me Influencë”, edhe ky projekt ka për qëllim që të sigurojë vazhdueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e Co-PLAN-it si një organizatë që vepron në mënyrë të pavarur, në përputhje me rolin e tij në forcimin dhe krijimin e një shoqërie civile gjithëpërfshirëse dhe në lehtësimin e partneriteteve ndërmjet komuniteteve, organizmave/strukturave qeveritare dhe sektorit privat në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës. Buxheti i programit është 212,400 Euro.

Programi përqendrohet në tre komponentë kryesorë, në kuadër të të cilëve do të ndërmerren një sërë aktivitetesh me rezultate të pritshme si më poshtë:

1. Shtrirja e Zbatimit të Modelit të Planifikimit me Pjesëmarrje. Pas ka arritur një përvojë në zbatimin e modelit [lexo: përjasjes] të planifikimit dhe zhvillimit urban me pjesëmarrje në qytete si Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë, të cilat deshmojnë rritje dhe ku sfida e zhvillimit është kanalizimi i energjisë së njerëzve dhe bizneseve me qëllim rritjen e produktivitetit të këtyre zonave, Co-PLAN synon shtrirjen e mëtejshme të modelit në qytete që shfaqen në rënie, ku sfida është rigjallërimi i qendrave urbane dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore. Të tilla qytete janë aktualisht Gjirokastra, Shkodra, Berati, etj. Nëpërmjet këtij programi do të asistohen dy bashki për të zbatuar nisma planifikimi urban apo strategjik me pjesëmarrje.



Perfshirja e studenteve në hartimin e planeve rregulluese: plani rregullues i Beratit



Nxjitja e qendrueshmerise se qyteteve pertej hartimit te planeve rregulluese: studentet deklarojne dashurine e tyre per qytetin



Hartimi i Planit Rregullues të Qytetit të Beratit

Bashkia Berat është tashmë një prej përfituesve të asistencës në kuadër të programit Krijimi i Partneriteteve, e cila ka kërkuar hartimin e një plani rregullues të qytetit. Berati është një rast tipik i një qyteti me trashëgimi unike. Hartimi i planit do të shtrihet në harkun e një viti. Aktualisht projekti ka nisur me fazën e organizimit të punës dhe mobilizimit. Kështu, janë zhvilluar disa takime me Kryetarin e Bashkisë si dhe me Zyrën e Urbanistikës në Bashki për vendosjen e marrëdhënieve, për të përcaktuar rolin drejtues që do të ketë bashkia përgjatë procesit të hartimit. Është arritur përcaktimi i marrëveshjes së bashkëpunimit, e cila do të nënshkruhet ndërmjet palëve Co-PLAN dhe Bashkia Berat. Gjithashtu, për zbatimin e procesit të hartimit të planit po mobilizohen grupet e punës që do të jenë dy: grupi bazë i punës dhe një grup ndërsektorial me përbërje të profesioneve të ndryshme nga komuniteti dhe grupe të tjera të interesit në qytet. Gjatë kësaj periudhe kanë nisur analizat paraprake të planit, ku janë zhvilluar dy vizita në terren për njohjen e qytetit, në të cilat janë përfshirë gjithashtu edhe studentë të degëve të arkitekturës dhe urbanistikës nga Universiteti i Tiranës. Së fundmi, është dixhitalizuar harta e qytetit.

2. Liderhip Institucional. Objektivi i dytë i programit Krijimi i Partneriteteve është mbështetja e rolit institucional të Co-PLAN-it si një organizatë zhvillimi profesionale pararojë. Gjatë viteve, funksionet institucionale të Co-PLAN-it janë shtuar duke i mundësuar organizatës të arrijë grupe të rëndësishme synimi dhe interesi, duke krijuar partneritete ndërmjet institucioneve aty ku ato mungojnë. Në këtë mënyrë, Co-PLAN ka arritur të kthehet në një derë të hapur për komunitetet, studentët, hartuesit e politikave, agjensitë e zhvillimit, institucionet e qeverisë në kërkim të ideve dhe praktikave të reja. Co-PLAN do të vazhdojë ta luajë këtë rol, nëpërmjet këtij programi, duke ndërmarrë aktivitete të tilla si debate dhe programe tematike televizive, spote, tryeza të rrumbullakta, mbështetje në bazë të kërkesës, shkëmbim vizitash, praktika studentësh, kryerje studimesh në bashkëpunim me universitetin, botime në fushën e menaxhimit urban etj.

3. Vazhdimi i Performancës Organizative. Objektivi i tretë i programit është të mbështesë dhe të vazhdojë forcimin e kapaciteteve organizative të Co-PLAN për të shërbyer në vazhdimësi si një pikë reference për sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Në këtë kuadër janë parashikuar kualifikimi dhe specializimi i mëtejshëm i stafit bazë, krahas pjesëmarrjes në konferenca dhe seminare, marrjes së asistencës teknike dhe raportimit dhe auditimit të përvitshëm të organizatës.

Hapa drejt Rehabilitimit Urban të Zonës informale të Kënetës

EMRI I PROJEKTTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integritetit të Komunitetit të Zonës me Zhvillim Informal Kënetë, Durrës	2004-2007	Agjensia Austriake e Zhvillimit ADA Cordaid Co-PLAN Bashkia Durrës	7688-00/2003 (ADA)	P0402-00

Ky projekt zbatohet në zonën e Kënetës, e cila është hapësira më e madhe me zhvillim informal me popullsi mbi 30 mijë banorë dhe sipërfaqe rreth 350 hektarë në qytetin e Durrësit. Projekti zbatohet në një zonë pilot 50 ha dhe financohet nga Qeveria Austriake me shumën 351,748 Euro, ndërsa Bashkia Durrës kontribuon me një vlerë 52,000 Euro. Qëllimi i projektit është integrimi i komunitetit të zonës me strukturat formale të Bashkisë Durrës, nëpërmjet proceseve të legalizimit dhe urbanizimit të zonës. Për këtë qëllim, Co-PLAN me mbështetjen e Bashkisë, po punon për kryerjen e planifikimit urbanistik të zonës me pjesëmarrjen e komunitetit dhe ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës fizike. Gjatë vitit 2005 projekti u përqendrua në realizimin e komponentëve të mëposhtëm:



Ndergjegjesimi i komunitetit mbi hartimin e planit pjesor urbanistik të zonës

1. Hartimi i planit urbanistik pjesor të zonës pilot. Hartimi i planit urbanistik të zonës, me përfshirje të komunitetit, përbën një element kryesor krijues të projektit. Gjatë vitit 2005 përfundoi me sukses përgatitja e Detyrës së Projektimit, e cila përbën pjesën e parë të hartimit të planit. Ky plan do të shërbejë si një mjet kyç në duart e komunitetit dhe Bashkisë Durrës mbi të cilin do të bazohet procesi i sistemit dhe legalizimit të zonës së Kënetës.



Trajnimi i organizates me baze komunitare te zones se Kenetes

2. Asistenca teknike për përgatitjen e dokumentacionit dhe zhvillimin e procesit te legalizimit. Një nga arritjet kryesore të projektit në 2005 ishte mobilizimi dhe mbështetja teknike e banorëve gjatë fazës së vetëdeklarimit të ndërtimit për legalizimin. Zona e projektit realizoi 75% te kesaj faze, krahasuar me 50% ne shkalle vendi, duke pasur parasysh ketu edhe zhvillimet politike për sa i përket trajtimit të çështjes së legalizimit. Asistenca u konkretizua me ngritjen e një sistemi të dhënash në bazë të vetëdeklarimeve të banorëve mbi ndërtimet e tyre informale. Gjithashtu, në vitin 2005 projekti kontribuoi në përcaktimin e kufijve të zonës informale, qe ishte nje ceshtje tjeter e rendesishme.

3. Pjesëmarrja e drejtperdrejtë e banorëve përgjatë hartimit të planit është themelore për të ndërtuar një plan të shëndoshë për zonën, jo vetëm nga ana teknike, por dhe sa i përket aspekteve sociale dhe

nevojave të komunitetit. Për këtë është punuar në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për strukturat me bazë komunitare dhe grupet më në nevojë si fëmijët, të rinjtë, gratë etj. Në mënyrë thelbësore, puna me komunitetin në këtë projekt ka kontribuar në organizimin e strukturave komunitare të përfaqësimit që ndërveprojnë jo vetëm me projektin por mbi të gjitha edhe për përfaqësimin e interesave të tyre në pushtetin vendor.



Fushata e ndergjegjesimit te komunitetit gjate fazes se vetedeklarimit per legalizimin

Për një panoramë të plotë të aktiviteteve të këtij projekti në 2005 shikoni shtojcën në këtë dokument.

Forcimi i Komuniteteve në Nevojë

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Forcimi i Kapaciteteve të Komuniteteve në Nevojë në Shqipëri	2003-2005	Novib	ALB-501043-0003037	P0307-00

Gjatë periudhës 3-vjeçare të zbatimit të tij, projekti për forcimin e kapaciteteve të komuniteteve në nevojë u përkushtua në zgjidhjen e problemeve sistematike të grupeve pa përkrahje/të anashkaluara, me qëllim fuqizimin dhe integrimin e tyre. Projekti u financua nga Novib me një buxhet total prej 150,000 Euro. Konkretisht, projekti u zhvillua në dy zona problematike: në Bathore (zona më e madhe informale në Ka-



Gabionet e ndertuara nga projekti buze lumit per parandalimin e permbytjeve te shtepive

mëz) dhe në Lagjen Allias/Tiranë, një zonë informale në një situatë edhe më të vështirë ku është përqendruar popullsia Rome e Tiranës. Instrumentat (aktivitetet) e zbatuara në të dy rastet ndoqën të njëjtin qëllim të përbashkët: aftësimin e komunitetit për të identifikuar, vetëmenaxhuar e parashtruar nevojat e tyre në nivel vendor. Projekti ka realizuar një impakt të rëndësishëm të përmbledhur më poshtë:

- 1. Organizimi i strukturave komunitare për veprime konkrete.** Gjatë projektit u punua nga njëra anë për të riorganizuar e forcuar organizativisht strukturat ekzistuese përfaqesuese komunitare (në Bathore) ose për të ngritur struktura aty ku mungonin (te Romët). Nga ana tjetër, u punua që edhe brenda pushtetit vendor të ngriheshin struktura me pjesëmarrje të gjerë edhe nga shoqëria civile, në Kamëz (p.sh. Komiteti i Koordinimit të Projekteve) dhe në Njësinë Bashkiake 10 të Tiranës (struktura koordinuese me përfaqësues romë dhe shoqatat në ndihmë të romëve). Për rrjedhojë, rezultatet më të dukshme në këtë proces ishin hartimi programeve ndërhyrëse dhe i plan-veprimeve me pjesëmarrje për zbatim, të tilla si hartimi i skemës mjedisore për grumbullimin



Gjate punes me komunitetin Rom



Perfshirja e komunitetit ne aktivite per permireshimin e zones

dhe depozitim e mbeturinave në Kamëz e Bathore, skema për legalizimin e zonës informale të Bathores, ndërtimi i ujësjellës-kanalizimeve në lagjen rome.

2. Lëvrime i projekteve konkrete nga komuniteti. Mandej procesi, veçanërisht në vitin e dytë, u zhvillua në mënyrë të tillë që, nëpërmjet një vargu trajnimesh në nivel vendor, strukturat e ngritura të fitonin aftësi vetëvepruese e menaxhuese për të hartuar e prezantuar dhe për të siguruar projekte tek donatori si dhe për të raportuar e dokumentuar zbatimin e tyre. Kështu, një varg miniprojektesh me karakter social janë realizuar nga vetë komunitetet në të dy zonat, të cilat kishin të bënin me edukimin arsimor e shëndetësor, higjienizimin, zhvillimin ekonomik e kulturor etj.

3. Forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit. Organizimet e riorganizimet e organizatave me bazë komuniteti, trajnimet, pjesëmarrja aktive në strukturat vendore dhe hartimi e vetëmenaxhimi i projekteve për zgjidhjen e nevojave, sollën impakte të rëndësishme të projektit, veçanërisht për forcimin e pavarësisë së strukturave komunitare, të rrjetit të shoqërisë civile, të bashkëpunimit me partnerë e aktorë të rëndësishëm vendorë dhe qendrorë si dhe për hedhjen e hapave të rëndësishëm për legalizim e integrim të këtyre komuniteteve në nevojë me pjesën urbane.

Për një panoramë të plotë të aktiviteteve të këtij projekti në 2005 shikoni shtojcën në këtë dokument.

Bashkëveprimi Ndërkomunal në Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimin Rajonal

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Bashkëveprimi Ndërkomunal në Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimin Rajonal	2006-2008	OSFA/SOROS	432/10016A	P0602-00

Ky projekt është në kuadër të Rrjetit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri (NOSA), të krijuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA). Rrjeti ka cilësuar procesin legjislativ, decentralizimin dhe administrimin e gjyqësorit si tre fushat prioritare në arritjen e mirëqënies së vendit. Projekti në fjalë angazhohet në fushën e decentralizimit, për të nxitur krijimin e praktikave të mira të bashkëveprimit ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Aktualisht, vlerësohet se mirëfunksionimi i niveleve të qeverisjes është ende larg përsa i përket ofrimit të shërbimeve publike me cilësinë e duhur për qytetarët. Projekti përqëndrohet në bashkëveprimin ndërkomunal në funksion të zhvillimit të balancuar rajonal përgjatë thellimit të procesit të decentralizimit dhe delegimit të kompetencave nga pushteti qendror drejt atij vendor. Projekti financohet nga OSFA, në kuadër të Rrjetit (NOSA), me një buxhet total prej 83,300 USD/Vit (75,000 Euro). Co-PLAN është zbatuesi kryesor i këtij projekti, i cili do të parashtrojë përfundimet për çështje të bashkëveprimit ndërkomunal në perspektivën e zhvillimit rajonal dhe në përputhje me zhvillimin hapësinor. Institucionet e tjera partnere në zbatim janë: Rrjeti i organizatave partnere të NOSA-s, PNUD, SNV, Ministria e Brendshme, njësitë vendore pilot si dhe aktorë të tjerë.

Komponentët e projektit janë si më poshtë:

1. Promovimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe zhvillimit Rajonal. Gjate punës kërkimore në terren, grupi i punës në Co-PLAN do të shqyrtojë kontekstin e përgjithshëm të decentralizimit në vend, duke evidencuar çështjet dhe sfidat e shfaqura në procesin e bashkëveprimit ndërkomunal në kuadrin e strategjisë së decentralizimit.

2. Shqyrtimi i një rasti konkret bashkëveprimi ndërkomunal. Projekti do të asistojë një rajon të caktuar në zbatimin e strategjive lidhur me shërbimin e qytetarëve. Raporti përfundimtar i kësaj faze me konkluzionet kryesore do të shpallet në Konferencën kombëtare që do të organizohet në vitin 2007.

Rasti studimor i transportit në Rajonin e Tiranës

Rajoni i Tiranës do të merret si studim pilot për të shqyrtuar situatën e transportit urban (qytetës dhe rrethqytetës / metropolitan), duke analizuar bashkërendimin aktual të komunave në këtë rajon në lidhje me këtë shërbim bazë për qytetarët. Projekti do të ngrejë dhe institucionalizojë një Grup Pune Ndërkomunal të Rajonit Metropolitan të Tiranës. Projekti do të zgjerohet gjithashtu me pilotimin e formave të ndryshme të bashkëveprimit/organizimit ndërkomunal në funksion të zhvillimeve social-ekonomike.

3. Përafrimi me politikat dhe direktivat e Bashkimit Evropian. Në bazë të gjetjeve dhe ecursë me rastin studimor të Tiranës dhe rasteve të tjera që mund të përfshihen, projekti do të shqyrtojë mundësitë e përafrimit të marrëdhënieve pushtet qendror-pushtet vendor me fokus zhvillimin rajonal me ato në sistemin Evropian.

Projekti Zhvillimi Urban dhe Përmirësimi Mjedisor në Bashkinë Kamëz

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Zhvillimi Urban dhe Përmirësimi Mjedisor në Bashkinë Kamëz nëpërmjet Bashkëpunimit Publik-Privat dhe Pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile	2003-2006	BE CISP Co-PLAN	CDC/2003/55-930	P0401-00

Projekti synon në zhvillimin urban të Bashkisë Kamëz për të frenuar shkatërrimin e mëtejshëm mjedisor dhe për të forcuar kapacitetet e autoriteteve vendore për sa i përket menaxhimit të shërbimeve bazë. Vlen të theksohet se Bashkia Kamëz është një bashki relativisht e re, me probleme mjaft mëdha zhvillimi informal, dhe projekti në fjalë është në vazhden e projektit të mëparshëm të zbatuar nga Co-PLAN në Bashkinë Kamëz “Fuqizimi i Pushtetit Vendor dhe Pjesëmarrjes së Komunitetit”. Projekti asiston Bashkinë dhe komunitetin e zonës për të ngritur dhe zhvilluar një skemë të qëndrueshme të pmenaxhimit të mbeturinave të ngurta urbane dhe për të ngritur kapacitetet dhe ndërgjegjësimin mjedisor. Buxheti i projektit është prej 262,920 Euro dhe financohet nga Komuniteti Evropian. Projekti zbatohet nga CISP (Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli) dhe Co-PLAN.

- **Zbatimi i skemës së menaxhimit të mbeturinave.** Gjatë vitit 2005 projekti vazhdoi të mbështesë zbatimin e skemës për menaxhimin e mbeturinave në dy zona pilot (eksperimentale), konkretisht në Bathore dhe Qendër Kamëz. Funksionimi i mirëfilltë i kësaj skeme, drejt arritjes së një qëndrueshmërie në menaxhimin e mbeturinave në Bashkinë Kamëz, përbën një sfidë që lidhet gjithashtu edhe me rritjen e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve publike ndaj qytetarëve.



Promovimi i skemes se mbeturinave ne Bathore

Mberrija e kazaneve të mbeturinave për skemën e zbatimit të mbeturinave



- **Ndërmjetësimi i autoriteteve dhe banorëve për përmirësimin e shërbimit.** Një aspekt i rëndësishëm i punës së projektit ishte në drejtim të vendosjes së një komunikimi të qëndrueshëm komunitet-pushtet vendor, për sa i përket realizimit të shërbimeve prioritare për qytetarin. Npërmjet kësaj përpjekjeje është arritur të konkretizohet përfaqësimi i komunitetit në strukturat vendimmarrëse të pushtetit vendor. Kjo ka çuar në një mbështetje dhe përgjigje më të madhe dhe aktive të komunitetit ndaj bashkisë, për sa u përket raporteve të ndërsjella ndërmjet përgjegjësisë qytetare me përligjjen e përsosjes së shërbimeve ndaj qytetarit. Edhe në punën me komunitetin është synuar rritja e ndërgjegjësimit mjedisor në brezat më të rinj (lexo: shkollat).
- **Rritja e Koordinimit.** Një element i rëndësishëm i projektit është funksionimi i plotë i Komitetit të Koordinimit të Projekteve brenda strukturës së Bashkisë. Ky komitet ka në përbërjen e tij qytetare të zonës dhe ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e vetë projektit dhe, çka është më e rëndësishme, komiteti po forcohet gjithnjë e më shumë si instrument për shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjithë projekteve të bashkisë, duke bashkërenduar iniciativat e aktorëve të ndryshëm.

Për një panoramë të plotë të aktiviteteve të këtij projekti në 2005 shikoni shtojcën në këtë dokument.

Prezantimi i skemes së mbeturinave në Bathore nga përfaqësi i komunitetit. Poshtë, Aktivitet pastrimi me fëmijet e shkollave në Ditën Botërore të Mjedisit në Kamez



Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë

EMRI I PROJEKTTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë	2006-2007	Cordaid	432/10036	P0601-00

Ky projekt i ri i Co-PLAN ka për qëllim të krijojë infrastrukturën e nevojshme për hapjen e debatit “mbi mundësinë e shqyrtimit dhe shfrytëzimit të formave të rinovueshme të energjisë” në Shqipëri. Duke u nisur nga situata e rënduar energjitike në Shqipëri, si pasojë e rritjes së kërkesës për konsumin e energjisë dhe përkeqësimit të kushteve të stacioneve hidrike nga të cilat prodhohet kryesisht energjia në vend, projekti për Energjitë e Qëndrueshme do të parashtrojë zhvillimin e skenarëve sa më interesantë dhe të vlefshëm për Shqipërinë, në mënyrë të veçantë për sa i përket rolit të mundshëm të energjive të rinovueshme. Projekti financohet nga Cordaid (Hollandë) me vlerën 199,577 Euro.

Diskutimi i synuar do të zhvillohet duke u bazuar mbi kërkimet shkencore dhe rastet studimore që do të ndërmerren, për t’i dhënë përgjigje pyetjes nëse mund të përfitojë vendi ynë, si një nga vendet në tranzicion, nga zhvillimet më të fundit të teknologjisë së sotme. Co-PLAN synon të koordinojë punën ndërmjet specialistëve dhe ekspertëve të fushës nga njëra anë, si dhe komunitetit dhe shoqërisë civile nga ana tjetër, për të hartuar një skenar sa tërheqës aq dhe realist për vlerësimin dhe shfrytëzimin e potencialeve të energjive të rinovueshme.

Projekti synon gjithashtu të parashtrojë problemin e zhvillimit të sektorit të energjisë në një afat më të gjatë, që përfshin përparësitë e prodhimit të decentralizuar të energjisë dhe hartimin e një plani veprimi mbi format e rinovueshme të energjisë si dhe mundësitë e futjes së teknologjive të avancuara që përdorin këto forma energjie. Aktualisht, Strategjia Kombëtare e Energjisë (2003) përqendrohet në një prodhim të centralizuar të energjisë, duke u mbështetur kryesisht në burimet tradicionale të energjisë.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e ndërgjegjësimin të opinionit publik, profesionistëve dhe autoriteteve përkatëse mbi çështjen e diversifikimit të burimeve energjitike, me fokus kryesor në Energjitë e Rinovueshme (përfshirë H₂) që do të stimulonin zhvillim në fushën ekonomike dhe atë të mjedisit në Shqipëri’.

Ndër objektivat kryesore të projektit janë:

- 1. Krijimi i mundësive për prodhimin e decentralizuar të energjisë në Shqipëri,** si një alternativë që duhet përfshirë në përgjithësimin e strategjisë aktuale kombëtare të energjisë. Pra, përcaktimi i mundësive dhe mënyrës që energjitë e rinovueshme (duke përfshirë edhe hidrogjenin) të mund të mbështesin prodhimin e decentralizuar të energjisë, me qëllim që rajone të ndryshme të fitojnë pavarësi në sigurimin e energjisë. Në këtë pikë, projekti do të parashtrojë një panoramë të teknologjive të disponueshme për prodhimin e decentralizuar të energjisë si dhe një përzgjedhje të atyre më të përshtatshme për rastin e Shqipërisë.
- 2. Përcaktimi i rolit të energjive të rinovueshme,** (përfshirë H₂), mund të luajnë në furnizimin e energjisë në procesin afatgjatë në Shqipëri. Në këtë pikë, projekti do të paraqesë një perspektivë përgjithësuese bashkëkohore dhe afatgjatë të mundësive/shanseve të energjive të rinovueshme (alternative).
- 3. Identifikimi i projekteve demonstruese** që mund të zhvillohen në kuadrin e projekteve Evropiane. Cordaid dhe Co-PLAN do të thellojnë më tej vizionin e tyre nëpërmjet një projekti demonstrativ me interes, i cili parashikohet të inkuadrohet në projektet e financuara nga Bashkimi Evropian. Gjithsej, do të lëvrohen 3 deri në 5 projekt-ide të mundshme për financim nga Bashkimi Evropian.

NET Rrjeti për Shkëmbim dhe Trajnim

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATOR	NUMRI I PROJEKTIT	
			DONATORI	Co-PLAN
NET Rrjeti për Shkëmbim dhe Trajnim	2004-2007	Cordaid	432/10036	P0308-00

NET është një projekt bashkëpunimi ndërmjet Co-PLAN dhe Cordaid si dhe partnerë të tjerë vendas dhe ndërkombëtarë. NET është një strukturë që shërben si organizatë platformë dhe që funksionon mbi parimet e bashkëpunimit në rrjet. Qëllimi i përgjithshëm i NET është të kontribuojë në proceset e zhvillimeve shoqërore nëpërmjet nxitjes së shkëmbimit dhe inovacioneve dhe krijimit të një forumi diskutimi në nivel vendor, kombëtar dhe rajonal.

Gjatë vitit 2005, NET funksionoi si një strukturë e konsoliduar dhe ofroi trajnime kalendar në tema si lidhshipi, komunikimi strategjik, menaxhim projekti, menaxhim financiar për financierë dhe jofinancierë, komunikim me inteligjencë emocionale si dhe trajnime sipas nevojave në subjekte të ndryshme biznesi apo organizata. NET ofroi gjithashtu asistencë të ndryshme për sektorin e organizatave jofitimruese si dhe ishte pjesë aktive në debatimin e temave aktuale nëpërmjet organizimit të tryezave të rumbullakëta, si për shembull lidhur me sistemin energjetik, paketën fiskale të ligjit për OJF-të, etj.

Një nga arritjet në vazhdimësi të NET ishte organizimi i Çmimit "Lidhshipi Shqiptar 2005". Këto çmime kanë për qëllim nxitjen e vlerave më të mira profesionale të shoqërisë shqiptare. Ngritja e një komiteti vlerësimit për përzgjedhjen e kandidatave dhe dhënien e çmimit, me personalitete të shquar nga fushat e çmimeve, si dhe publiciteti i vazhdueshëm, po e shdërrojnë këtë në një traditë dinjitoze. Katër çmimet e akorduara sipas fushave për vitin 2005 nga komiteti i lidhshipit ishin: (i) në fushën e biznesit, Kompania Western Union; (ii); për shoqërinë civile Valda Sala; (iii) në fushën e qeverisjes, Artur Kurti, Kryetar i Bashkisë së Kuçovës; dhe (iv) në fushën e medias Blendi Fevziu.



Pjesëmarrësit gjatë një seance trajnimi në menaxhimin e projekteve

Për një panoramë të plotë të aktiviteteve të NET në 2005 shikoni shtojcën në këtë dokument.

Për më shumë informacion vizitoni www.co-plan.org/net ose kontaktoni në net@coplan.org

Pamje nga një trajnim për menaxhimin financiar


Mjedisi

Prej disa vitesh, Co-PLAN është angazhuar në hartimin dhe zbatimin e një politike mjedisore për organizatën, si pjesë e rolit mbështetës ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Ngritja e një politike të tillë dhe ndjekja e saj në vazhdimësi është një proces afatgjatë i cili zbatohet nga Co-PLAN në hapa progresivë çdo vit. Politika mjedisore është e orientuar në dy drejtime kryesore:

1. Politika për aktivitete të brendshme të menaxhimit të organizatës
2. Politika mjedisore në projektet zhvillimore të Co-PLAN

1. Komponenti mjedisor në nivel organizate


Për sa u përket aktiviteteve të brendshme, që prej vitit 2000 Co-PLAN ka nisur me monitorimin e energjisë, telefonisë fikse dhe të përdorimit të automjeteve. Në vitin 2003, Co-PLAN ka kristalizuar dhe pasqyruar për herë të parë edhe në Manualin e Procedurave dokumentin e politikës mjedisore, ndërkohë që prej vitit 2005 ka nisur edhe me monitorimin e përdorimit dhe konsumit të letrës.



Grafiku i letrës mbeturinë për vitin 2005 tregon konsumin e organizatës brenda zyrave. Prodherimi më i lartë i mbeturinave në muajt shtator-tetor lidhet me rimarrjen e punës pas pushimeve dhe me pjesëmarrjen në disa aktivitete të rëndësishme përfaqësuese, siç ishte përgatitja e materialeve për Konferencën dhe Panairin Ndërkombëtar mbi Zvillimin e Qëndrueshëm në Gjenevë etj. Analizimi i situatës mjedisore brenda organizatës në vitin e ardhshëm do të shqyrtojë

gjithashtu edhe sasitë e letrës së blerë në raport me aktivitetin e kryer.

Vështirësitë aktuale të evidentuara në procesin e zbatimit të politikës mjedisore në menaxhimin e organizatës lidhen me ndryshimin e sjelljes ndaj burimeve dhe mjedisit, veçanërisht në rastin e përdorimit të energjisë, ujit etj. Ndërsa përdorimi i energjisë apo makinave është më i kontrollueshëm dhe mund të shoqërohet edhe me masa korrektimi, monitorimi i plotë i letrës paraqitet më i vështirë dhe si pasojë edhe marrja e masave përmirësuese është më e vështirë. Për të vëzhguar ecurinë e sjelljes së organizatës për sa i përket letrës, është e domosdosme që monitorimi i letrës të shtrihet edhe më shumë në kohë në raport me produktet dhe shërbimet e realizuara.





Aktivitet pastrimi ne Diten Boterore te Mjedisit ne zonen e Kenetes.

Poshtë, femijet ne nje aktivitet ndergjegjesues per mjedisin ne Kenete nepermjet projektit

2. Komponenti Mjedor në Projektet e Zhvillimit të Co-PLAN

Mjedisi është gjithashtu një komponent i drejtpërdrejtë ose i ndërthurur në pothuajse të gjitha projektet e Co-PLANit.

- Një ndër projektet që lidhen ngushtë me mjedisin është Projekti në Bashkinë Kamëz për Përmirësimin Mjedor nëpërmjet Bashkëpunimit Publik-Privat dhe Pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile, në të cilin po mbështetet eksperimentimi dhe shtrirja e një skeme të re për menaxhimin e mbeturinave.
- Gjithashtu, mjedisi është i përfshirë edhe në Programin Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane (EGUG II) që po zbatohet në Bashkinë Elbasan dhe Bashkinë Fier, si një ndër katër komponentët përbërës të Strategjive të Zhvillimit të Qytetit të hartuar për secilën nga këto qytete. Gjatë proceseve të hartimit të strategjive në secilin prej dy qyteteve u ngrit një grup tematik për mjedisin si dhe u përgatit një profil mjedor i qytetit, u hartua një dokument lokal për mjedisin dhe së fundmi po kryhet procesi i vlerësimit strategjik mjedor për planin rregullues.
- Nisma më e re e Co-PLAN në vitin 2006 është Projekti “Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë”, me anë të të cilit Co-PLAN synon mundësimin e një debati “Mbi mundësinë e eksplorimit dhe shfrytëzimit të këtyre formave të rinovueshme të energjisë”, ku objektivi përfundimtar është të kontribuohet në përmirësimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë.
- Co-PLAN e ka institucionalizuar angazhimin mjedor brenda organizatës edhe përmes krijimit të njësisë së mjedisit si një nga tre departamentet kryesore të Co-PLAN si dhe ka përcaktuar menaxhimin bashkiak mjedor si një nga temat përmbajtësore të aktivitetit të organizatës.



- Në rastin e Projektit “Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integrimit të Komunitetit të Zonës Informale në Kënetë, Durrës”, mjedisi është një temë trajnimi për komunitetin dhe madje për këtë qëllim edhe janë angazhuar nga Co-PLAN OJF mjedisorë për mbështetje.
- Së fundi, Co-PLAN merr pjesë në të gjitha forumet mjedisorë të organizuara nga organizata të ndryshme mjedisorë si edhe nga institucionet publike.

Përkatësia Gjimore

Co-PLAN është përkushtuar këtë vit në hartimin e një politike gjimore organizative, në përpjekjen për të ngritur performancën e standardeve dhe vlerave përsa i përket ndjeshmërisë dhe barazisë gjimore. Politika organizative gjimore është në fazën e hartimit, elementë të së cilës reflektohen tashmë si brenda organizatës në procedurat e brendshme të funksionimit të saj dhe në dimensionin e zbatimit të projekteve.

Përgjatë vitit 2005 ka një proces jo vetëm të qëndrueshëm por dhe progresivisht pozitiv në raport me vitin 2004 për sa i përket përkatësisë gjimore. Co-PLAN është një organizatë që integron në mënyrë efektive përkatësinë gjimore, duke zhvilluar në këtë mënyrë një kulturë organizative që i përgjigjet barazisë gjimore (*gender-responsive*). Nëpërmjet kësaj kulture funksionimi dhe komunikimi, secili i përgjigjet pozitivisht kërkesës së organizatës për të brendësuar e shfaqur ndjeshmërinë ndaj barazisë gjimore, si pjesë të ndërveprimeve të tyre të përditshme, përgjegjësi dhe të drejtave në marrëdhëniet e ndërtuara në punë dhe gjatë procesit të saj. Në hapat e zbatimit dhe strukturimit të politikës gjimore në organizatë, janë arritur objektiva të adresimit dhe plotësimit të nevojave të femrave dhe meshkujve si për rritje profesionale ashtu dhe duke ruajtur dinamikën e zhvillimit personal të tyre në të.



Panair për promovimin e prodhimeve të artizanatit të punuara nga grate e zonës Kenete organizuar nga projekti në Ditën e Gruas

tin 2004 për sa i përket përkatësisë gjimore. Co-PLAN është një organizatë që integron në mënyrë efektive përkatësinë gjimore, duke zhvilluar në këtë mënyrë një kulturë organizative që i përgjigjet barazisë gjimore (*gender-responsive*). Nëpërmjet kësaj kulture funksionimi dhe komunikimi, secili i përgjigjet pozitivisht kërkesës së organizatës për të brendësuar e shfaqur ndjeshmërinë ndaj barazisë gjimore, si pjesë të ndërveprimeve të tyre të përditshme, përgjegjësi dhe të drejtave në marrëdhëniet e ndërtuara në punë dhe gjatë procesit të saj. Në hapat e zbatimit dhe strukturimit të politikës gjimore në organizatë, janë arritur objektiva të adresimit dhe plotësimit të nevojave të femrave dhe meshkujve si për rritje profesionale ashtu dhe duke ruajtur dinamikën e zhvillimit personal të tyre në të.

Në nivel organizate:

- Shpërndarja e barabarte e përgjegjësi/detyrave dhe privilegjeve orientuar drejt profesionalizmit, statusit, hierarkisë apo titullit që mbart në organizatë.
- Ristrukturimi i burimeve njerëzore duke mundësuar praninë e profesioneve të ndryshme në vendet e punës brenda organizatës që mbahen nga femrat (jo vetëm profesioneve që cilësohen si vetëm për femra apo vetëm për meshkuj), psh financiare, planifikuese urbane, administratore, psikologe, punonjëse sociale etj...
- Promovimi dhe/apo inkurajimi i femrave për dhe gjatë procesit të aplikimit për një vend pune në organizatë, duke u bazuar në kriteret e arsimit, kualifikimit, përvojës në punë dhe profesionalizmit.
- Raporte të përmirësuar duke synuar ekuilibrim të pozicioneve drejtuese dhe/apo vendimmarëse nëpërmjet përfaqësimit në strukturat përkatëse.

- Kualifikimi dhe motivimi i të punësuarve femra duke ofruar shanse të barabarta dhe nxitje për kualifikime pasuniversitare të shkallëve të ndryshme.
- Politikë e barabartë në nivelin e dhënies së pagave në punë (për pozicione pune të njëjtë ndiqet e njëjta pagesë)
- Procedurat e barabarta të punësimit dhe kontraktimit duke filluar me procesin e nxjerrjes së njoftimit për një vend të lirë, procesit të intervistimit dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin si rezultat i një kontrate punësimi sipas ligjeve shqiptare në fuqi duke respektuar kodin e punës.
- Mundësimi dhe aprovimi i një orari fleksibël për nevojat e femrave dhe meshkujve në organizatë nga stafi në tërësi.
- Krijimi i mundësive për mjedise të përshtashmë dhe funksionale në punë, si fizike ashtu dhe sociale.
- Sigurimi i aksesit të barabartë të përdorimit të mjeteve apo të mirave materiale, logjistike të organizatës.
- Trajnime dhe ekspertizë në fushën e përkatësisë gjinore (3 trainerë të Co-PLAN)
- Bashkëpunimi dhe partneriteti me organizata me fokus fushën e përkatësisë gjinore (Qendra për Aleancën Gjinore, në dobi të Gruas Shqiptare etj...)

Ecuria pozitive gjatë 2005 mishërohet jo vetëm në raport me modelin organizativ që operon dhe tendencat gjinore jodiskriminuese, por dhe me shërbimet e ofruara nga Co-PLAN për grupet e përfituesve (komunitet, pushtet vendor etj.), në nivelin e zbatimit të programeve dhe projekteve të Co-PLAN përgjatë kësaj kohe.



Promovimi i pjesëmarrjes së grave në diskutimet në grupet e punës në zonen e Kenetes

Në nivel të zbatimit të programeve dhe projekteve:

- Synohet drejt nxitjes së përfaqësisë së barabartë gjatë procesit të pjesëmarrjes si të femrave ashtu dhe të meshkujve në nivele të ndryshme të organizimit shoqëror, ekonomik dhe politik si në komunitet, struktura apo organizata me bazë komunitare, grupe tematike pune të pushtetit lokal e deri në struktura drejtuese apo vendim-
- marrëse të këtij niveli.
- Ngritja e strukturave në mbrojtje të barazisë gjinore në komunitet (shoqata apo organizime me bazë komunitare nga gratë dhe për gratë).
- Organizimi i aktiviteteve masive në ditën simbolike ndërkombëtare të gruas me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, kërkesës dhe përgjegjësisë në emër të të drejtave të barabarta

- Puna në nivel vendor nëpërmjet projekteve pranë bashkive të ndryshme është tejet i rëndësishëm sepse vendimet që merren në këtë nivel kanë një ndikim të drejtpërdrejtë tek njerëzit. Pra ndikimi për nxitjen e elementeve gjinore do të mundësonte një rezultat më progresiv për qytetarët në përgjithësi dhe për një shpërndarje të të mirave dhe shërbimeve publike në mënyrë të ndjeshme për komunitetin femëror.
- Publikimi në median lokale për rritjen e ndërgjegjësimit në fushën gjinore (gazeta lokale dhe komunitare) me kontribut në shkrime që ngacmojnë reagimin dhe nxisin ndryshimin e mentalitetit, qëndrimeve dhe sjelljeve në zonat ku aplikohen projektet.
- Trainimi në fushën e përkatësisë gjinore për nivele të ndryshme organizohet në mënyrë periodike në funksion edhe të planifikimit të trainimeve sipas planeve operationale të secilit projekt në veçanti.
- Është punuar dhe miratuar për zbatim një modul në fushën e përkatësisë gjinore si pjesë e tërësisë së moduleve në fusha të tjera me të cilat operon NET (Rrjeti për shkëmbime dhe trainim).

Disa shifra domethënëse

- 1 projekt i zbatuar në Bathore nga shoqata me bazë komunitare "Gruaja e së Ardhmes" me qëllim nxitjen e vetëpunësimit të grave në zonë
- 1 dyqan me punime dore i ngritur në zonë
- 20 gra të vetëpunësuar
- 100 gra të trainuara në fushën e përkatësisë gjinore si elemente aktive në komunitetin e Bathores
- 5 organizata me bazë komunitare në Bathore me 18 pjesëmarrës të trainuar në fushën gender, nga të cilët 8 femra dhe 10 meshkuj
- 4 struktura rinore dhe të grave me bazë komunitare të ngritura në zonat informale Bathore dhe Kënetë
- Organizimi i përvitshëm i ditës ndërkombëtare të gruas në zonat informale Bathore dhe Kënetë
- 80 gra të trainuara dhe aktive në fushën gjinore në Kënetë.
- Trainime periodike me grupet tematike të bashkive Kamëz dhe Durrës për rritjen e ndjeshmërisë gjinore në procesin e punës (tre grupe tematike për çdo bashki)
- 20 gra të asistuar në komunitetin rom, Lagjja Allias Bregu i Lumit me ndihmë mjekësore, asistencë psikologjike, kurs formimi për shkrim dhe këndim

Përhapja e Njohurive dhe Komunikimi

Një nga veçoritë më dalluese të punës së Co-PLAN është komunikimi i hapur dhe i drejtpërdrejtë me grupet e synuara dhe partnerët. Zgjerimi i përvojës dhe aktivitetit në vitet e fundit ka çuar në rritjen e shumëllojshmërisë së mjeteve dhe mënyrave të komunikimit dhe të përçimit të njohurive të fituara, si në nivelin e organizatës dhe në nivelin e projekteve të zhvillimit, ashtu edhe nga niveli lokal në atë ndërkombëtar.

Në sajë të përvojës së fituar, Co-PLAN është formuar si një qendër e rëndësishme burimore, e hapur për komunitete, studentë, hartues politikash, agjensi zhvillimi, institucione të qeverisë, të cilët janë në kërkim të ideve dhe praktikave të reja urbane. Co-PLAN do të vazhdojë të luajë këtë rol nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, që përfshijnë debate apo programe tematike në media, tryeza të rrumbullakëta, mbështetje, shkëmbim vizitash, praktika për studentët, studime të përbashkëta (me universitetin), publikime etj.



Percimi i njohurive gjatë një ore mesimi me studentet e arkitektures në Universitetin Tiranë

Përfshirja e Studentëve të Arkitekturës/Urbanistikës Tiranë

Vazhdimisht në nismat dhe projektet e ndërmarra Co-PLAN ka tërhequr studentë me qëllimin për t'u përcjellë atyre përvojën konkrete të grumbulluar nga puna disavjeçare në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban. Praktika e vlefshme e përfshirjes së studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës, Degët Arkitekturë/Urbanistikë, në kuadër të hartimit të planeve rregulluese të qytetit Elbasan dhe Fier, po vazhdon edhe në projektin e hartimit të planit rregullues të qytetit të Beratit.

Shtojcë: Raportimi i Projekteve për Vitin 2005

RAPORTIMI PËR VITIN 2005 - PROGRAMI "DREJT NJË QEVERISJEJE TË MIRË URBANE (EGUG II)"		
	REZULTATET	TREGUESIT E PUNES
Qëllimi i Programit	Nxitja e praktikave të suksesshme nëpërmjet mbështetjes së qeverive vendore, organizatave joqeveritare dhe komunitetit të biznesit për t'u përfshirë në mënyrë konstruktive në zhvillimin, zbatimin dhe përhapjen e praktikave të suksesshme në qeverisjen urbane në lokalitete të zgjedhura në Shqipëri	
Objektivi 1	Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit dhe Planeve të tjera me Pjesëmarrjen e Aktorëve Lokalë të Interesuar Elbasan/Fier	
Zbatimi	1. Strategjia dhe Portofoli i Projekteve hartuar dhe miratuar me komunitetin	• Versioni 1 i strategjive botuar / 2 dokumenta strategjikë realizuar • 2 Forume Qytetare zhvilluar / 250 pjesëmarrës • Versioni 2 i strategjive në proces
	2. Detyra e Projektimit për Planin Rregullues Urban hartuar dhe miratuar	• 2 dokumenta të Detyrës së Projektimit realizuar • 10 takime zhvilluar me grupet tematike urbane • 10 takime zhvilluar me instancat në nivel lokal, rajonal, qendror për miratim ligjor
	3. Plani i Zhvillimit Ekonomik Lokal në proces hartimi	• 15 takime zhvilluar me grupet tematike ekonomike • 45 intervista kryer në sektorin e biznesit • Përgatitja e dokumentit të planit në proces
	4. Profili Mjedisor i bashkisë në proces hartimi	• 5 takime zhvilluar me grupet tematike të mjedisit • 10 intervista kryer në fushën e mjedisit • Përgatitja e dokumentit të profilit në proces
	5. Profili i Arsimit-Kulturës për bashkinë në proces hartimi	• 4 takime me grupet tematike të arsimit-kulturës • 6 intervista kryer në fushën e arsimit dhe kulturës • Përgatitja e dokumentit të Profilit në proces
Objektivi 2	Zbatimi i Projekteve Pilot Elbasan/Fier	
Zbatimi	1. Ngritja e Sistemit të Informacionit në bashki	• 2 Regjistrime të Popullsisë-Ndërtesave kryer / 2 databaza letër dhe elektronike realizuar • 100 harta tematike për profilin territorial prodhuar • Analizë institucionale ndërmarrë për Bashkinë Elbasan / 1 Raport Paraprak realizuar
	2. Përmirësimi i hapësirave të gjelbra në qytet	• 16 projekte lulishtesh në zbatim
Objektivi 3	Zhvillimi i Kapaciteteve në Nivel Vendor Elbasan/Fier	
Zbatimi	1. Asistencë teknike dhe udhëzim i vazhdueshëm për stafin bashkiak	• 11 zyrtarë bashkiakë të zyrave të programit në Bashki asistohen
	2. Vizitë studimore realizuar në Republikën Çeke	• 3 zyrtarë pjesëmarrës (2 bashkitë dhe 1 ministria) • 3 bashki të vizituara
Objektivi 4	Përhapja e Njohurive për Palë të Interesuara Elbasan/Fier	
Zbatimi	1. Fushatë komunikimi dhe informimi publik zbatuar në mënyrë të vazhdueshme	• 30 kronika/debate televizive të transmetuara në TV lokale • 6 spote televizive realizuar / transmetuar • 12 postera tematikë realizuar • 6 broshura tematike realizuar • 2 galeri/ekspozita përgatitur/hapur
	2. Platforma e Njohurive në proces realizimi	• Nr.1 i Buletinit Informativ i botuar • Faqe interneti e programit krijuar • 1 dokumentar DVD i programit në realizim • 1 CD Toolkit në realizim
	3. Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme promovuese	• Prezantime në 2 seminare kombëtare • 1 stendë përgatitur për Panairin e Pushtetit Vendor Tiranë • 3 stenda të përgatitura (2 bashkitë/Co-PLAN) dhe 1 workshop Ndërkombëtar mbajtur në Konferencën e Zhvillimit të Qëndrueshëm Gjenevë
	4. Monitorim-Vlerësim i vazhdueshëm i aktiviteteve të programit	• 1 takim i Komunitetit Mbikqyrës zhvilluar • 2 takime zhvilluar të Grupeve Drejtuese • raportime periodike në këshillin bashkiak

Raportimi i Projekteve për Vitin 2005

RAPORTIMI PËR VITIN 2005 - PROJEKTI "HAPA DREJT REHABILITIMIT URBAN DHE INTEGRIMIT TË ZONËS INFORMALE KËNETË"		
	REZULTATET	TREGUESIT E ZBATIMIT
Qëllimi i Programit	Krijimi i një modeli për integrimin urban të një zone informale nëpërmjet përfshirjes dhe fuqizimit të banorëve të komunitetit në procesin e hartimit të planit urban.	
Objektivi 1	Përgatitja e Planit Urbanistik Pjesor të Zonës me Pjesëmarrjen e Komunitetit	
Zbatimi	1. Të dhënat për hartimin e Detyrës së Projektimit grumbulluar dhe analizuar	25 takime zhvilluar me përfaqësues të ndërmarrjeve publike
	2. Detyra e Projektimit paraqitur dhe miratuar në nivel vendor	7 takime diskutimi zhvilluar me bashkinë 3 takime të Grupit të Menaxhimit të Projektit
	3. Projekt-idea për planin urbanistik pjesor të zonës hartuar dhe diskutuar me komunitetin	20 takime zhvilluar me bashkinë 12 takime zhvilluar në komunitet / 500 pjesëmarrës 1 takim zhvilluar me të gjithë aktorët në proces
	4. Fushatë ndërgjegjësimi dhe informimi ndërmarrë për planin	500 fletëpalosje shpërndarë 3 kronika transmetuar në TV lokale
Objektivi 2	Ofrimi i Asistencës për komunitetin dhe autoritetet vendore gjatë zbatimit të procesit të legalizimit për përgatitjen e dokumentacionit përkatës dhe zhvillimin e procesit	
Zbatimi	1. Metodologjia për zbatimin e ligjit të legalizimit të zonave informale e hartuar dhe miratuar	1 takim koordinimi zhvilluar / 30 përfaqësues (Ministria, Zyra e Bashkëpunimit Teknik Ambasada Austriake, Prefektura, Bashkia, OJF)
	2. Baza elektronike dhe hartografike e të dhënave ngritur	9 harta tematike realizuar 1050 planimetri të parcelave përgatitur gjithsej (për çdo ngastër në zonën pilot)
	3. Procesi i vetëdeklarimit në proces zbatimi	75% e vetëdeklarimit realizuar 10 takime zhvilluar në komunitet / 500 banorë pjesëmarrës 1000 banorë asistuar në plotësimin e formularëve 780 dosje dokumentacioni të plotësuar
	4. Bashkëpunim i projektit vendosur me pushtetin qendror dhe vendor	4 takime zhvilluar në nivel qendror - takime koordinuese zhvilluar me njësinë e legalizimit në zonë
	5. Fushatë ndërgjegjësimi dhe informimi ndërmarrë për legalizimin	2 numra të Buletinit informativ botuar / 1000 kopje 1 emision transmetuar në TV lokal
Objektivi 3	Organizimi dhe Ngritja e Kapaciteteve Vendore për të marrë pjesë në Zhvillimin dhe Integrimin e Zonës nëpërmjet Hartimit të Programit të Zhvillimit të Zonës	
Zbatimi	1. Ristrukturimi dhe fuqizimi i organizatës me bazë komunitare të krijuar në zonë	- Anëtarësia e re në OBK 200 banorë - Përfaqësia e zgjedhur 32 vetë / 20 burra, 10 gra dhe 2 të rinj - Kryesia e formuar 5 vetë / 3 gra, 2 burra
	2. Aktivizimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve dhe trajnimeve në zonë	1 grup rinor formuar / 50 të rinj pjesëmarrës - Kurse gjuhe Anglisht organizuar / 50 të rinj pjesëmarrës 10 trajnime të dhëna mbi integrimin / 100 pjesëmarrës 4 aktivitete mjedisore organizuar / 150 pjesëmarrës - Panair për 8 Marsin organizuar / 1000 pjesëmarrës
	3. Fillimi i procesit të hartimit të Programit të Zhvillimit Vendor	2 grupe tematike ngritur për mjedisin dhe infrastrukturën 10 takime komunitare mbi infrastrukturën / 100 banorë
	4. Partneriteti komunitet-pushtet vendor fuqizuar	1 trajnim zhvilluar për njësinë administrative dhe komunitetin / 27 pjesëmarrës 4 takime zhvilluar me bashkinë dhe komunitetin / 30 pjesëmarrës 1 takim dhe konsultim mbajtur për vendndodhjen e shkollës së re të Kënetës / 23 pjesëmarrës
Objektivi 4	Ofrimi i Asistencës Teknike për Stafin Bashkiak në Hartimin e Planit Urbanistik Pjesor me pjesëmarrje	
Zbatimi	1. Asistence dhënë në hartimin e planit urbanistik pjesor me pjesëmarrje	30 takime me drejtorinë e urbanistikës zhvilluar 8 punonjës të bashkisë të asistuar
	2. Asistencë dhënë nga ekspertë austriakë	15 ditë / 18 takime - procesin e legalizimit, hartimin e planit urbanistik me pjesëmarrje, të projekteve teknike, të programit të zhvillimit të lagjes
	3. Vizitë studimore kryer në Austri	8 zyrtarë bashkiakë pjesëmarrës
	4. Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm i zbatimit të Projektit	3 takime vendimmarrje kryer nga Grupi i Menaxhimit të Programit

RAPORTIMI PËR VITIN 2005- PROJEKTI "FORCIMI I KAPACITETEVE TË KOMUNITETEVE NË NEVOJE NË SHQIPËRI"		
	REZULTATET	TREGUESIT E ZBATIMIT
Objektivi 1	Forcimi i kapaciteteve të Organizatave me Bazë Komunitare për arritjen e përfaqësimit të tyre me të drejta të plota, si dhe aftësimin në zbatimin e Planit të Zhvillimit të Lagjes	
Zbatimi	1. Rrjeti i organizatave me bazë komunitare në Bathore i formuar dhe në aktivitet	10 takime me pjesëmarrje në çdo takim të 5 organizatave me bazë komunitare, Bathore
	2. Trajtime për ngritjen e kapaciteteve dhënë organizatave me bazë komunitare në Bathore	5 trajtime të organizuara / 100 pjesëmarrës nga organizatat me bazë komunitare Bathore
	3. Grupet tematike të lehtësuara dhe monitoruara në procesin e prioritarizimit dhe zbatimit të planeve të veprimit	130 vetë pjesëmarrës të rregullt në proces 5 grupe menaxhimi të miniprojekteve të ngritura / 30 anëtarë pjesëmarrës 25 grupe pune të ngritura / 100 anëtarë pjesëmarrës 10 trajtime të realizuara nga vetë organizatat komunitare në Bathore / 150 persona pjesëmarrës 20 takime me komunitetin të realizuara në zonë / 500 persona pjesëmarrës 1 workshop organizuar për prioritarizimin e planeve të veprimit / 5 grupe menaxhimi pjesëmarrës / 5 modele (çështje përparësore) të krijuara (mjedisi, legalizimi, arsimi, financa, kultura) / 15 projekte të identifikuara
	4. Miniprojekte të mbështetura dhe realizuara nëpërmjet organizatave me bazë komunitare në Bathore	7 (nga 15) miniprojekte të zbatuara nga 5 organizata komunitare në Bathore: 2 libra të botuar/publikuar në 800 kopje 1 bibliotekë me 150 tituj librash hapur në qendrën komunitare për të rinjtë e zonës - kurs veror organizuar për përfshirjen e nxënësve që kanë braktisur shkollën në procesin mësimor / 56 fëmijë të integruar në procesin e arsimit për vitin e ri akademik - Studim social-ekonomik realizuar në Bathore / 800 pyetësore të kryer / raporti shumëfishuar në 40 kopje. 1 dyqan artizanal me punime dore nga gratë - pastrimi i kanalit kolektor të drenazhimit të Bathores
	5. Ngritja dhe funksionimi i një gazete komunitare të qëndrueshme	8 numra të gazetës komunitare "Vision" të botuara
Objektivi 2	Sigurimi i asistencës për Bashkinë Kamëz në hartimin e një sistemi monitorimi dhe zbatimin e Planit të Zhvillimit Strategjik Urban	
Zbatimi	1. Komiteti i Koordinimit të Projekteve (KPP) në monitorim dhe koordinim të projekteve të ndryshme që zbatohen në Bashkinë Kamëz	5 mbledhje të KKP-së realizuar në Kamëz / 25 pjesëmarrës në takime
	2. Sistemi i monitorimit dhe treguesit përkatës të hartuar	1 platformë monitorimi e përgatitur dhe miratuar për zbatim / 3 skema të hartuara për zbatimin e PzhSU
	3. Grupet e punës në Bashkinë Kamëz në funksionim për zbatimin e PZhSU të Kamzës	3 grupe pune të ngritura (për legalizimin, financat dhe mjedisin) / 18 persona pjesëmarrës nga Bashkia (6 për çdo grup) 18 takime zhvilluar (6 për çdo grup) / 100 pjesëmarrës
Objektivi 3	Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe nxitja e edukimit qytetar për komunitetin Rom në lagjen Plasmasi-Allias	
Zbatimi	1. Nxitja e arsimit të banorëve të zonës	2 kurse mujore kundër analfabetizmit organizuar në zonë / 15 gra, 15 burra rom pjesëmarrës
	2. Nxitja e kujdesit shëndetësor tek banorët rome	- Vizitë mjekësore gjinekologjike/pediatrike kryer / 20 gra + 50 fëmijë të asistuar - Vizitë mjekësore e përgjith. kryer për komunitetin / 100 vetë të asistuar

	3. Komuniteti Rom i fuqizuar nëpërmjet mobilizimit dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e ndryshme	• 10 takime <i>fokus grup</i> zhvilluar me gra dhe të rinj / 5 çështje sociale të diskutuara (planifikimi familjar, zhvillimi i barazisë gjinore, nxitja e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve, dhuna në familje, parandalimi i trafikimit të fëmijëve dhe grave) • Struktura përfaqësuese komunitare rome të ngritura në zonë / 1 zyrë e hapur për adresimin e nevojave të banorëve rom brenda lagjes së tyre / 1 strukturë komunitare rome me anëtarësi 20 vetë • Fuqizimi i mobilizimit dhe pjesëmarrjes komunitare të komunitetit rom / 1 platformë zhvillimi komunitar strategjik e hartuar dhe miratuar për zbatim
	4. Ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës zbatuar në zonë sipas prioriteteve të platformës/programit të komunitetit	• 4 aktivitete ndërgjegjëse të përgjithshme pastrimi me bazë lagje të organizuara për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit • 9 gabione gurore të ndërtuara përgjatë lumit për parandalimin e përmytjeve nga shirat / 56 familje rome përfituese • 300m rrugë niveluar dhe zhavorruar për përmirësimin e infrastrukturës rrugore • 500m linear mur dhe fasadë të riparuar, lyer dhe gëlqerizuar për ruatjen e pastërtisë dhe higjienës publike

RAPORTIMI PËR VITIN 2005 - PROJEKTI "PËRMIRËSIMI MJEDISOR NË BASHKINË KAMËZ"		
	REZULTATET	TREGUESIT E ZBATIMIT
Qëllimi i projektit	Të kontribuojë në përmirësimin e kushteve mjedisore dhe të higjenes në Bashkinë Kamëz nëpërmjet forcimit të kapaciteteve vendore dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe fillimit të një përvoje pilot të bashkëpunimit publik-privat për skemën e menaxhimit të mbeturinave	
Objektivi 1	Monitorimi i veprimtarisë së projektit nga Komiteti i Koordinimit të Projekteve	
Zbatimi	1. Komiteti i Koordinimit të Projektit (KPP) në funksionim aktiv të vazhdueshëm për monitorimin e veprimtarisë së projektit	3 mbledhje të KPP zhvilluar 2 dokumenta të miratuar 1 skemë e mbeturinave 1 rregullore për menaxhimin e mbeturinave
	2. Grupi i Punës për Mjedisin në funksionim aktiv	1 seminar pune organizuar / 20 pjesëmarrës
Objektivi 2	Fillimi i zbatimit të skemës për menaxhimin e mbeturinave në dy zonat pilot në territorin e Kamzës	
Zbatimi	1. Grupi i Menaxhimit Mjedisor ngritur dhe në funksionim	- Grupi përbërë nga 5 anëtarë 2-3 studime paraprake përgatitur për përmirësimin e venddepozitimit të mbeturinave 1 takim seminar i organizuar mbi përvojën e re të grumbullimit të mbeturinave nga ekspertë vendorë: 12 pjesëmarrës
	2. Rregullore e përgatitur dhe miratuar për menaxhimin e mbeturinave për bashkinë	Rregullorja miratuar nga Këshilli Komunal dhe Prefektura
	3. Vënia në zbatim e skemës së mbeturinave	1 takim prezantues organizuar / 20 pjesëmarrës 2 zona zbatimi të skemës
	4. Pajisje dhe mjete të tjera pune siguruar për funksionimin e skemës së pastrimit	- Makineri teknologjike shërbimi siguruar 46 kazanë të rinj mbeturinash të vendosur nëpër zonë
	5. Aksione pastrimi ndërmarrë nëpër zonë	650 m³ mbeturina sistemuar në venddepozitimin e mbeturinave për të rritur kapacitetin 218 m i kanalit kolektor të drenazhimit në Bathore pastruar nëpërmjet Shoqatës Rilindja
Objektivi 3	Përmirësimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore nëpërmjet asistencës teknike dhe trajnimit	
Zbatimi	1. Zbatimi i programeve financiare bashkëkohore në bashki	- programi financiar Alfa instaluar 1 trajnim zhvilluar / 3 të trajnuar nga Departamenti i Financës në bashki
	2. Ndërmarrja e Pastrim/Gjelbërimit mbështetur për përmirësimin e shërbimit	- procedurat e punës përmirësuar - kostot për njësi të grumbullimit të mbeturinave të përcaktuara
Objektivi 4	Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit vendor dhe edukimit mjedisor në shkollat e Kamzës	
zbatimi	1. Informimi i komunitetit mbi zbatimin e skemës	1 shfaqje artistike promovuese e të rinjve zhvilluar / 1000 pjesëmarrës qytetarë dhe nxënës 3 takime publike të zhvilluara / 65 pjesëmarrës 1000 fletëpalosje shpërndarë
	2. Organizimi i aktiviteteve promovuese në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit (5 Qershor) dhe Ditën e Qyteteve të Pastra (22 Shtator)	2 banderola vendosur nëpër qytet - Hapja e ekspozitës së vizatimeve për mjedisin / 9 shkolla dhe 270 nxënës pjesëmarrës / 30-40 vizatime paraqitur në çdo shkollë - Demonstrime të skemës së mbeturinave kryer në komunitet / 2 shkolla & 160 pjesëmarrës përfshirë
	3. Grupi didaktik për mjedisin me mësuesit në funksionim dhe aktiv	1 seminar organizuar / 15 mësues pjesëmarrës 1 seri prej 9 kurrikulash mjedisore përgatitur për shkollat
	4. Rritja e përdorimit të burimeve njerëzore në kuadër të bashkëpunimit me institucione partnere	- marrëveshje arritur me Fakultetin e Shkencave Sociale 2 studentë praktikantë të përfshirë në kuadër të zbatimit të projektit
	5. Pasqyrim i aktivitetit të projektit në median e shkruar	6 artikuj botuar në gazetën "Mjedis Sot" & Vizion (komunitare)

Raportimi i Projekteve për Vitin 2005

RAPORTIMI PËR VITIN 2005 - PROJEKTI "NET RRJETI PËR SHKËMBIM DHE TRAJNIM"		
	REZULTATET	TREGUESIT E ZBATIMIT
Qëllimi i programit	NET është një qendër trajnimi, asistence dhe informimi që promovon më shumë mirëkuptim në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit, nëpërmjet proceseve për një qeverisje të mirë, përgjegjësi sociale dhe zhvillim organizativ	
Objektivi 1	Ofrimi dhe zhvillimi i trajnimeve, asistencës teknike dhe ngritja e kapaciteteve në mbështetje të zhvillimit institucional dhe organizativ	
Zbatimi	1. Trajnues të identifikuar	38 % e trajnuesve dhe bashkëtrajnuesve brenda Co-PLAN 62% jashtë Co-PLAN
	2. Trajnim nga DBR i dhënë për trajnuesit e Co-PLAN	1 trajnim 3-ditor / 15 pjesëmarrës
	3. Kurrikulat e trajnimit zhvilluar	4 kurrikula brenda NET/Co-PLAN 8 ofruar nga trajnuesit e jashtëm
	4. Fushatë marketimi për shërbimet e NET e ndërmarrë bazuar në kalendarin e trajnimeve	- Dita e Hapur e Trajnimeve organizuar / 12 module trajnimi prezantuar / 100 pjesëmarrës, 21 organizata pjesëmarrëse 1 broshurë për trajnimet realizuar / 300 kopje të shpërndara 1000 kopje të broshurave të NET, broshura mbi kalendarin e trajnimeve zhvilluar dhe shpërndarë 10 takime të kryera me përfaqësues shtetërorë, të shoqërisë civile dhe private / 100 specialistë pjesëmarrës 1000 + njerëz kontaktuar nëpërmjet letrave, postës elektronike, kontakteve të drejtpërdrejta 21 njoftime në 2 gazeta për 2 sezonet e trajnimeve të NET - Faqe interneti e NET ndërtuar dhe mirëmbajtur
	5. Trajtime të hapura të zhvilluara	2 faza trajnimesh realizuar 12 trajtime zhvilluar (16 planifikuar) 84 të trajnuar / nga 39 organizata
	6. Konsulenca dhe trajtime të ofruara	9 organizata të asistuar 2 organizata të asistuar me afat të gjatë 2 organizata kërkesë për zgjerim të asistencës nga NET brenda 3 muajsh 17 organizata të vlerësuara mbi aftësitë organizative në menaxhimin financiar
	7. Trajtime të zhvilluara sipas nevojave të organizatave	7 trajtime për sektorin e OJF-ve 1 trajnim për sektorin privat (British American Tobacco) 2 trajtime mbi përkatësinë gjinore / 20 trajnuar nga UNDP dhe 40 të trajnuar nga administrata publike 1 trajnim në zhvillim për Raiffeisen Bank në fushën e menaxhimit
Objektivi 2	Identifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve që garantojnë shpërndarjen e informacionit, krijim dhe bashkëpunim rrjeti, shpërndarje njohurish të tilla si seminare për lidhshmëri, debate për politika, forume, tryeza donatorësh, tryeza të rrumbullakta etj	
Zbatimi	1. Takime dhe aktivitete publike të zhvilluara	1 tryezë e rrumbullakët organizuar me OJF për pjesën fiskale të ligjit për OJF-të / 21 organizata pjesëmarrëse, 60 pjesëmarrës 1 forum i organizuar mbi çështjet e energjisë / 13 ente pjesëmarrëse, 25 pjesëmarrës 2 takime me partnerë të Cordaid / 11 organizata pjesëmarrëse 1 takim me partnerë të ICCO / 16 organizata pjesëmarrëse, 40 pjesëmarrës
	2. "Fletët e Verdha" të OJF-ve Shqiptare	Mbështetje për hartimin dhe plotësimin e fletëve të verdha të OJF-ve shqiptare në internet
	3. Çmimet Shqiptare për Lidhshmëri 2005 të shpërndarë	- Komiteti i Lidhshmërit 2005 ngritur / 5 personalitete nga fushat përkatëse / 2 takime organizuar 21 kandidatura propozuar nga publiku i gjerë 3 njoftime në gazete 1 javë publicitet në media 4 çmime të shpërndara nga Komiteti i Lidhshmërit - Ceremonia e çmimeve e organizuar / 300 vetë pjesëmarrës 4 ditë transmetim në media e aktivitetit

SHËRBIMET QË OFRON Co-PLAN

Co-PLAN ofron shërbime të cilat janë të përqendruara në sferën e planifikimit dhe zhvillimit urban dhe qeverisjes urbane si dhe zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri dhe rajon. Shërbimet e ofruara dhe produktet e realizuara nga Co-PLAN janë në këto fusha:

EKSPERTIZA E CO-PLAN

1. Menaxhimi Urban dhe Rajonal	• Planifikimi urban dhe rajonal • Planifikimi hapësinor • Financat e bashkive • Zhvillimi ekonomik vendor • Pjesëmarrja e komunitetit • Rregullarizimi dhe legalizimi • Sistemet e informacionit
2. Menaxhimi Mjedisor i Bashkive	• Politikat mjedisore të Bashkive • Menaxhimi i mbetjeve të ngurta • Energjia
3. Strehimi	• Strehimi social • Roli i shoqatave të strehimit • Financat e strehimit • Rregullarizimi dhe legalizimi
4. Zhvillimi Institucional dhe Organizativ	(NET)

Adresa: Rruga Dervish Hima, Kulla Ada,
Nr. 11, Kutia Postare 2995, Tiranë

Telefon: +355 (0) 4 257808/9

Celular: +355 (0) 69 20 32957

Fax: +355 (0) 4 257807

E-mail: co-plan@co-plan.org

Internet: www.co-plan.org

SHËRBIMET QË OFRON NET

Rrjeti për Shkëmbim dhe Trajnime (NET) është një njësi trajnimesh dhe asistence që ofron ekspertizë në fushën e menaxhimit, zhvillimit organizativ dhe institucional në tërësi dhe në proceset e lidhura me to; trajnime të hapura për pjesëmarrës të fushave dhe sektorëve të ndryshëm dhe të hartuara specifikisht për organizata (tailor made) të cilat dëshirojnë të trajnojnë stafin e tyre dhe asistencë teknike drejpërdrejt në punë; si dhe promovon vlerat e shoqërisë.

EKSPERTIZA E NET

Trajnime dhe asistencë teknike për kompani/organizata	• Pozicionimi Organizativ dhe Strategjitë • Struktura Organizative • Sistemet dhe Proceset • Menaxhimi i Burimeve Njerëzore • Menaxhimi Financiar • Planifikimi, Monitorimi dhe vlerësimi • Komunikimi
Promovim të vlerave në shoqëri	• Çmimet 'Lidershipi Shqiptar' (Shoqëria Civile, Biznesi Privat, Qeverisja e Mirë, dhe Media)
Trajnime të hapura	• Shprehi Bazë të Menaxhimit dhe Lidershipit • Menaxhim Efektiv i Kohës • Komunikim nëpërmjet 'Inteligjencës Emocionale' • Shprehjet e Prezantimit në Publik • Menaxhim Projekti • Menaxhim Strategjik • Menaxhim mbi Bazë Rezultatesh • Buxhetimi • Projektimi dhe Monitorimi i Rrjedhës së Parasë • Menaxhim Financiar për Personelin e Financës • Menaxhim Financiar për Menaxheret



NETWORK FOR EXCHANGE AND TRAINING
RRJETI PËR SHKËMBIME DHE TRAINIM

Adresa: Rruga Dervish Hima, Kulla Ada,
Nr. 4, Kutia Postare 2995, Tiranë
Telefon: +355 (0) 4 257808/9
Fax: +355 (0) 4 257807
Internet: www.co-plan.org/net
E-mail: net@co-plan.org